

V E N D I M
Nr.457, datë 22.7.1998

PËR MIRATIMIN E STATUTIT TË INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS

Në mbështetje të nenit 9 të ligjit nr.7896, datë 13.8.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës", me propozimin e Ministrisë së Punës dhe Çështjeve Sociale, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

Miratimin e Statutit të Inspektoratit Shtetëror të Punës (ISHP).
Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KRYEMINISTRI
Fatos Nano

STATUTI I INSPEKTORATIT SHTETËROR TË PUNËS

Hyrje

Inspektorati Shtetëror i Punës, që më poshtë do të quhet ISHP është institucion publik shtetëror. Veprimtaria e tij rregullohet me ligjin nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës" dhe dispozitat e këtij statuti.

ISHP-ja me qendër në Tiranë kryen veprimtarinë e tij, në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë.

Neni 1
Veprimtaria e ISHP-së

Në veprimtarinë e tij ISHP-ja ka për detyrë të sigurojë zbatimin e legjislacionit të punës.

Neni 2
Shpërndarja administrative e ISHP- së

Numri i inspektorëve të ISHP-së është 130 vetë, i shpërndarë në të gjithë territorin e Republikës së Shqipërisë, në përputhje me pikën a të nenit 9 të ligjit nr.7986, datë 13.9.1995 "Për Inspektoratin Shtetëror të Punës".

Neni 3
Organizimi dhe drejtimi

Drejtimi i veprimtarisë së ISHP-së kryhet nga inspektori i përgjithshëm. Drejtoria qendrore kryen veprimtari tekniko-administrative, ndërsa shërbimet realizohen nëpërmjet zyra në nivel prefekturë dhe lokale.

Strukturat në nivel prefekturë dhe lokale janë pjesë e administratës së ISHP-së.

Neni 4

Inspektori i përgjithshëm

Inspektori i përgjithshëm emërohet nga ministri dhe miratohet nga Këshilli i Ministrave. Ai përfaqëson ISHP-në dhe drejton veprimtarinë e tij. Inspektori i përgjithshëm ka detyrë të propozojë:

- a) drejtimet e përgjithshme dhe metodikën e kontrollit të ISHP-së;
- b) rregulloren e brendshme të funksionimit administrativ të ISHP-së;
- c) strukturën dhe numrin e punonjësve të ISHP-së;
- d) emërimin e inspektorëve të punës në nivel qendror, prefekturë dhe lokal;
- e) temat për formimin e vazhdueshëm dhe special profesional të inspektorëve/kontrollorëve të punës në bashkëpunim me Institutin e Punës.

Inspektori i përgjithshëm ka për detyrë t'i paraqesë raportin vjetor të vitit paraardhës ministrit, brenda 3 muajve dhe Kuvendit Popullor brenda 6 muajve.

Neni 5

Këshilli konsultativ

1. Për rritjen e efikasitetit të ISHP-së, Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale miraton këshillin konsultativ, i cili përbëhet nga 14 anëtarë, të cilët përfaqësojnë subjektet si më poshtë:

1. Inspektoratin sanitar shtetëror.
2. Inspektoratin e sigurimit teknik.
3. Inspektoratin e pajisjeve në presion.
4. Inspektoratin e sigurimit teknik, pajisjeve dhe instalimeve elektrike.
5. Inspektoratin e mbrojtjes nga zjarri.
6. Inspektoratin rrugor.
7. Dhomën e tregtisë dhe industrisë.
8. Institutin e sigurimeve shoqërore.
9. Komitetin e mbrojtjes së mjedisit.
10. Policinë e ndërtimit.
11. Organizatat punëmarrëse (dy përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara).
12. Organizatat e punëdhënësve (dy përfaqësues nga organizatat më të përfaqësuara).

2. Anëtarët emërohen për 1 vit me propozim të institucioneve dhe organizatave përkatëse.

Përfundimi i anëtarësisë në këshillin konsultativ:

- a) kur anëtari jep dorëheqjen;
- b) në rast vdekjeje;
- c) për paaftësi;
- d) kur veprimet e tyre bien në kundërshtim me ligjin.

Në rastet e largimit të anëtarëve të këshillit, për rastet e lartpërmendura dhe ndonjë arsye tjetër të përligjur, institucionet përkatëse bëjnë propozimin për zëvendësimin e tyre menjëherë.

Neni 6

Drejtimi dhe mbledhja e këshillit konsultativ

Këshilli konsultativ drejtohet nga inspektori i përgjithshëm dhe mbledhet prej tij jo më pak se tri herë në vit, kundrejt një shpërblimi të përcaktuar nga Ministria e Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 7

Detyrat e këshillit konsultativ

- a) Të diskutojë të gjitha çështjet që lidhen me kushtet, shëndetin dhe sigurinë në punë.
- b) Të vlerësojë nivelin e zbatimit të legjislacionit të punës, për mbrojtjen e punëmarrësit dhe punëdhënësit, si dhe kushtet e punës dhe shëndetit në mjediset e punës.
- c) Të nxisë bashkëpunimin efektiv ndërmjet inspektorateve dhe institucioneve të tjera.
- d) T'i raportojë për veprimtaritë e tij një herë në vit Ministrit të Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 8

Marrja në punë

Kandidatët për inspektor pune zgjidhen me konkurs. Çdo vend pune do të publikohet.

Kushtet për të marrë pjesë në konkurrim janë:

- a) të ketë diplomën e shkollës së lartë, me prioritet në specialitetet inxhinierike, drejtësi, ekonomik;
- b) të ketë jo më pak se 5 vjet eksperiencë pune;
- c) të jenë të moshës nën 40 vjeç;
- d) për çdo vend pune të konkurrojnë jo më pak se 3 kandidatura;
- e) personeli ndihmës do t'i provojë aftësitë e tij në bazë të dispozitave të kodit të punës.

Inspektori i përgjithshëm krijon dhe drejton komisionin e konkurrimit.

Neni 9

Barazia

Në përzgjedhjen e personelit të Inspektoratit të Punës, respektohet barazia në konkurrim e burrave dhe grave.

Neni 10

Marrja e titullit inspektor i ISHP-së

Kandidati, i cili fiton konkursin për një vend pune do të punojë 6 muaj si ndihmës inspektor (kontrollor) dhe pas kësaj për të vërtetuar aftësitë e tij do t'i nënshtrohet testimit për të marrë titullin inspektor pune. Testimi bëhet nga komisioni i konkurrimit. Nëse

ndihmës inspektori nuk e provon aftësinë e tij do të vazhdojë edhe tre muaj të tjerë si ndihmës, pas së cilës humbet të drejtën për t'u emëruar si inspektor pune.

Neni 11

Pavarësia e inspektorëve

Inspektorët dhe kontrollorët e Inspektoratit Shtetëror të Punës, për shkak të statutit të tyre gëzojnë mbrojtje të veçantë ligjore. Ata nuk mund të jenë subjekt i largimit nga puna për shkak të ndryshimeve politike.

Neni 12

Masat disiplinore

Për inspektorët, të cilët shkelin dispozitat e ligjit dhe të këtij statuti në lidhje me Inspektoratin e Punës, kur veprimet e tyre nuk përbëjnë vepër penale, merren këto masa disiplinore nga inspektori i përgjithshëm:

- a) Vërejtje.
- b) Vërejtje me paralajmërim.
- c) Pezullimi i përkohshëm me afat deri në 1 muaj.
- d) I propozon ministrit për shkarkim nga detyra.

Kundër vendimit të inspektoratit të përgjithshëm mund të bëhet ankim brenda 5 ditëve te Ministri i Punës dhe Çështjeve Sociale.

Neni 13

Kualifikimi i vazhdueshëm

Në veprimtaritë e tyre, inspektorët e punës krahas inspektimeve do t'i nënshtrohen një formimi periodik, sipas programeve të miratuara nga inspektori i përgjithshëm.

Neni 14

Dispozitat e fundit

Ky statut hyn në fuqi me miratimin e tij nga Këshilli i Ministrave.